

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrrete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve: H. H. nga fshati K. Komuna e Suharekës dhe B. M. nga fshati S. Komuna e Suharekës, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.675/2015 të datës 26.09.2016, pas mbajtjes së seancës fillestare në praninë e prokurorit të shtetit në Prizren Sahide Sefa dhe të akuzuarve, me datë 22.08.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

H. H. nga i ati F. dhe e ëma K. e lindur K., i lindur më datë *data e lindjes...* në fshatin K. Komuna e Suharekës ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor i ndërtimtarisë, i pa martuar, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

B. M. nga i ati I. dhe e ëma I. e lindur B., i lindur më datë *data e lindjes...* në Suharekë tani me banim në fshatin S. Komuna e Suharekës, ka të kryer shkollën e mesme, hidro-instalues, i pa martuar, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

JANË FAJTOR

Me datë 27.02.2015 rreth orës 16:50 minuta, në Prizren rrugën ... në Qendrën Tregtare ..., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete e shfrytëzon momentin e volitshëm dhe në bashkëveprim nga lokali i dëmtuarës ia marrinë pasurinë e luajtshme dhe atë 3 (tri) palë pantallona gjins, kështu i shkaktojnë dëm material të dëmtuarës në vlerë prej 40 €.

Kësodore në bashkëveprim kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK.

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 325 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK iu shqipton dënimin dhe atë:

DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarit **H. H.** vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Të akuzuarit **B. M.** vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

E dëmtuara Qendra Tregtare ... në Prizren rruga..., nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohen të akuzuarit në mënyrë solidare të paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës si dhe në emër të paushallit gjyqësor secili prej tyre veç e veç të paguaj shumën prej nga 20 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Mbikëqyrjen e dënimit me kusht do të bëjë Shërbimi Sprovues në Prizren në pajtim me nenin 159 par.1 të LESP.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.675/2015 të datës 26.09.2016, kundër të akuzuarve: H. H. nga fshati K. Komuna e Suharekës dhe B. M. nga fshati S. Komuna e Suharekës, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarve. Të akuzuarit pas kësaj deklaruan se kanë kuptuar aktakuzën dhe nuk e kundërshton provat materiale.

Gjykata në seancën fillestare ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike në datë 27.02.2015 rreth orës 16:50 minuta, në Prizren në Qendrën Tregtare ... e cila gjendet në rrugën ... të akuzuarit H. H. dhe B. M. në bashkëveprim me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete e shfrytëzon momentin e volitshëm dhe nga raftet ku është ekspozuar malli nga aty marrin 3 (tri) palë pantallona – gjins në vlerë prej 40 €, në këtë mënyrë i shkakton dëm material të dëmtuarit.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e akuzuarve për veprimet e përshkruara si në përshkrimin faktik të aktakuzës. Gjykata nuk ka administruar provat, pasi që nuk ka ekzistuar ndonjë provë e papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale me të cilën ngarkohen dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht. Vlen të theksohet se pranimi i fajit është mbështetur në fakte që përmban aktakuza, me ç'rast të akuzuarit prej fillimit të procedurës kanë qenë të njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat asnjëherë nuk i kanë kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarve është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK dhe në veprimet e tyre formohen të gjitha elementet e qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit ta shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese morri parasysh faktin se kanë

pranuar fajësinë dhe kanë tregu bashkëpunim me organet e drejtësisë, sjellja korrekte gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi për kryerjen e veprës penale, janë gjendjes së dobët ekonomike dhe mbajtës i familjeve të tyre, gjer më tani nuk kanë kryer vepër penale, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata iu shqiptoj dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tyre dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahen nga veprimet e këtilla, me bindje se është proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën të akuzuarit janë shpallur fajtor.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarës në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.2081/2016 të datës 22.08.2017

Procesmbajtësja
Myrvete Përdibuka

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.